



FAKULTETI I ARTEVE TE BUKURA

KONTRATË INDIVIDUALE E PUNËS

URDHËR

Nr. 4, Datë 01/06/2016

PËR EMËRIMIN NË FUNKSIONIN E DREJTUESIT TË NJËSISË BAZË "SKULPTURË" TË PROF. ASC. PJERIN GJON KOLNIKAJ.

Mbështetur në nenin 42 (*Drejtuesi i njësisë kryesore*), pika 2, nenit 45 (*Drejtuesi i njësisë bazë*), të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit nr. 13, date 21.04.2016 të KZF – FAB, Vendimi nr.50, date 25.04.2016 të KIZ,

Prof. Asc. Pjerin Kolnikaj, i cili ka nënshkruar kontratën individuale të punës, është emëruar në funksionin e drejtuesit të njësisë bazë "Skulpturë" në Fakultetin e Arteve të Bukura.

URDHËROJ:

- 1) Emërimin e Prof. Asc. Pjerin Gjon Kolnikaj, në funksionin e drejtuesit të njësisë bazë, "Departamentit Skulpturë", në Fakultetin Arteve të Bukura;
- 2) Pagesa të fillojë nga data 01/06/2016;
- 3) Bashkëlidhur, Kontrata Individuale e Punës;
- 4) Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, DMBNJ, Drejtorja Ekonomike dhe K/Sekretarja e FAB.
- 5) Ky urdhër, të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve;

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Asc. Ardian ISUFI

DEKAN
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA